



Deklaratë për shtyp - 569/07/2020

Ministri Laumann: „Vazhdoni të respektoni rregullat bazë kundër infeksioneve të reja– Përdoreni lirinë e veprimit me përgjegjësi“

12.07.2020
Faqja 1 nga 2
Zyra për shtyp e kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Kabineti përcakton ndryshimet për urdhëresën e mbrojtjes nga koronavirusi dhe për urdhëresën e udhëtimeve hyrëse për sa i përket koronavirusit / Zgjatje deri në 11 Gusht

Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ju komunikon:

Kabineti i Nordrhein-Westfalen ka përcaktuar sot ndryshimet për urdhëresën e mbrojtjes nga koronavirusi dhe për urdhëresën e udhëtimeve hyrëse për sa i përket koronavirusit dhe i ka zgjeruar ato deri në 11 Gusht 2020. Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale do të publikojë së shpejti rregulloret përkatëse.

„Ecuria pozitive kombëtare e vazhdueshme e shifrave na jep neve hapësira më të vogla për manovrim, të cilat duam t'i përdorim në mënyrë të përgjegjshme për më shumë liri“, u shpreh Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann. „Por ne nuk duhet të harrojmë: Pandemia nuk ka mbaruar dhe ne duhet të vazhdojmë të jemi shumë vigjilentë dhe të përgjegjshëm. Këtë gjë e tregojnë zonat e nxehta në qarqe të caktuara. Si rrjedhim, përveç rregullave të përgjithshme të higjienës, janë thelbësore tre rregulla bazë: Parimi i distancës fizike, vendosja e një maske e cila mbulon hundën dhe gojën dhe siguri i gjurmimit të zinxhirëve të infeksionit.“

Tek urdhëresa e mbrojtjes nga koronavirusi, ndryshimet e tanishme rrisin numrin e individëve të cilëve u lejohej të ndjekin evenimente. Kjo vlen mbi të gjitha për festime në raste të veçanta, veçanërisht dasma, të cilat mund të festohen tani me deri në 150 njerëz, me kusht që të sigurohet gjurmimi i kontaktit fizik të pjesëmarrësve. E njëjta gjë vlen për funeralet. Për evenimente kulturore dhe të llojeve të tjera, kufiri mbi të cilin duhet të dorëzohet plani i higjienës është rritur nga 100 në 300 persona. Kufizimi për sportet me kontakt fizik në salla do të rritet nga 10 në 30 persona. Gjithashtu numri i spektatorëve të lejuar do të rritet nga 100 në 300.

Ka gjithashtu disa ndryshime të rëndësishme për sa i përket hyrjes nga zonat me rrezik: Rregullorja e hyrjes së koronavirusit merr tani parasysh faktin që kapacitete të mjaftueshme testimi janë të gatshme të zhvillojnë testimet të cilat janë në parim të dëshirueshme për hyrjet dhe kthimet nga shtetet me rrezik të përcaktuara nga Instituti Robert Koch. Rastet e përjashtimet të karantinës së detyruar janë reduktuar në përputhje me rrethanat. Në veçanti, punonjësit e infrastrukturave kritike të cilët i shpenzojnë udhëtimet e verës në një zonë me rrezik nuk janë automatikisht të përjashtuar nga detyrimi i karantinës, por vetëm pas një testi negativ. E njëjta gjë vlen nëse një vizitë tek familjarët ka ndodhur në një zonë me rrezik. Ministri Laumann shpjegon: „ Sa më shumë liri të kemi, aq më e rëndësishme është të identifikojmë personat e infektuar sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet testimeve, dhe nëse është e mundur, të vendosim kufizime të shkurtra për kontaktin fizik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e rreziqeve më të mëdha të infeksionit, si për shembull qëndrimi në një zonë rreziku, e cila është veçanërisht e rëndësishme tani në kohë pushimesh. “

Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, Telefon 0211 855-3118.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)